

**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

---

## RAPORT

### I

## AVOKATIT TË POPULLIT

**Ex officio nr. 521/2022**

lidhur me

*bazën ligjore të ri-vlerësimit nga Komisioni për vlerësimin dhe përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit dhe të drejtave të personave paraplegjik dhe tetraplegjik*

Për:

Z. Hekuran Murati, Ministër

Ministria e Financave Punës dhe Transfereve

Kopje:

Z. Albin Kurti, Kryeministër

Qeveria e Republikës së Kosovës

Z. Habit Hajredini, Drejtor

Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 22 dhjetor 2023

## QËLLIMI I RAPORTIT

1. Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) për çështjet që kanë të bëjnë me bazën ligjore të ri-vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga Komisioni për vlerësimin dhe përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit të personave paraplegjik dhe tetraplegjik sipas Ligjit nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik.
2. Gjithashtu, raporti ka për qëllim të vendos theksin përkitazi me bazën ligjore për rivlerësim nga Komisioni për vlerësimin dhe përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit të personave paraplegjik dhe tetraplegjik, bazuar në Rregulloren (QRK) nr.07/2017 për përbërjen, funksionimin, përgjegjësitë e Komisionit vlerësues dhe përcaktimin e procedurave për njohjen e statutit dhe të drejtave të personave paraplegjik dhe tetraplegjik.

### I. KOMPETENCA E AVOKATIT TË POPULLIT

3. Avokati i Popullit sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - *“Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime me iniciativën e vet (ex officio), nëse ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut” (neni 16, par. 4);*
  - *“të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, par. 1, nënpar. 2);*
  - *“të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave (neni 18, par. 1, nënpar. 4);*
  - *“të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (neni 18, par. 1, nënpar. 5);*
  - *“t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, par. 1, nënpar. 6);*
  - *“të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës (neni 18, par. 1, nënpar. 7);*
  - *“t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (neni 18, par. 1, nënpar. 9).*
4. Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi ligjore.

## II. RRETHANAT E RASTIT


5. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka vendosur të hap rast sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) lidhur me bazën ligjore të ri-vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga Komisioni për vlerësimin dhe përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit dhe të drejtave të personave paraplegjik dhe tetraplegjik në Kosovë.
6. Më 25 korrik 2023, Avokati i Popullit ka dërguar një shkresë në MFPT për të kërkuar informata lidhur me bazën ligjore të ri-vlerësimin e aftësisë së kufizuar sipas Ligjit nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, duke marrë parasysh se ky ligj nuk përcakton rivlerësimin e statusit të personave paraplegjik dhe tetraplegjik dhe se një rivlerësim i tillë është paraparë me akt nënligjor, përkatësisht me Rregulloren (QRK) Nr. 07/2017 për Përbërjen, Funksonimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.
7. Nëpërmes kësaj shkrese, Avokati i Popullit ka kërkuar edhe informatat, si në vijim:
  - Cili është vlerësimi i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në lidhje me vlerësimin dhe përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit dhe të drejtave të personave paraplegjik dhe tetraplegjik?
  - Cilët janë mekanizmat monitorues të komisioneve vlerësuese?
  - Sa personave u është njohur statusi i personave paraplegjik dhe tetraplegjik, të ndara sipas viteve 2019-2022?
  - Sa është numri i ankesave të parashtruara nga personat paraplegjik dhe tetraplegjik, për vitet 2019-2022, në Komisionin e Ankesave në nivel të ministrisë, dhe sa prej tyre janë të bazuara, të pabazuara apo të hedhura poshtë dhe cilat janë pretendimet kryesore të ankesave të paraqitura?
8. Më 9 gusht 2023, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga MFPT me të cilën ofrohen sqarime lidhur me çështjet e ngritura nga Avokati i Popullit. Sa i përket dy pyetjeve të para, MFPT ka sqaruar se pajtohet se ekzistojnë probleme të natyrave të ndryshme lidhur me vlerësimin dhe monitorimin e procesit. MFPT ka sqaruar se edhe pse procesit të aplikimit dhe trajtimit të lëndëve i kushtohet prioritet, ekzistojnë probleme lidhur me përmbajtjen e vlerësimeve. Më tej, MFPT sqaron se ekipet e angazhuara në komisionet e shkallës së parë dhe shkallës së dytë lidhur me përcaktimin e grupit të fituesve janë profesionistë (mjekë) që kryesisht nuk kanë marrëdhënie pune me MFPT dhe se MFPT shërbehet nga këta profesionistë bazuar në një marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë/SHSKUK. Sipas MFPT, kjo formë e bashkëpunimit nuk është duke siguruar llogaridhënie në mes të anëtarëve të komisioneve dhe menaxhmentit të MFPT dhe as evidenca të mjaftueshme për të argumentuar justifikimin për sistemimin e një përfituesi në grupin e parë dhe grupin e dytë. Për këtë arsye, thuhet se MFPT tashmë ka hartuar "Projekt Rregulloren e re për përbërjen, funksionimin, përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit dhe të drejtave të personave paraplegjik dhe tetraplegjik", ku në mes tjerash, do të adresohet mënyra e kontraktimit dhe funksionimit të gjitha komisioneve lidhur me vlerësimet për përfituesit e skemës së personave paraplegjik dhe tetraplegjik.

9. Sa i përket çështjes së mekanizmave monitorues të komisioneve vlerësuese, MFPT ka sqaruar se në kuadër të ish Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është themeluar Divizioni për Monitorimin dhe Kontroll të Zyrave të Pensioneve në kuadër të Departamentit të Pensioneve. Kjo njësi ka pasur përgjegjësi për monitorimin e zbatimit të legjisacionit përkatës me qëllim të identifikimit dhe korrigjimit të gabimeve, por kjo njësi për shkaqe të ndryshme, nuk ka zhvilluar monitorime të mjaftueshme lidhur me punën e vlerësimeve lidhur me skemat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik. MFPT ka njoftuar se me rregullimin e ri të organizimit të brendshëm të MFPT, kjo njësi tashmë ka një nivel më të lartë të pavarësisë dhe se me aprovimin e *“Projekt Rregullores se re për përbërjen, funksionimin, përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit dhe të drejtave të personave paraplegjik dhe tetraplegjik”* përveç monitorimeve që bëhet nga kjo njësi edhe profesionistët (mjekët) e angazhuar do të kenë një mbikëqyrje të zbatimit të kontratës sipas rregullave të prokurimit publik.
10. MFPT ka ofruar të dhëna sa i përket personave të cilëve u është njohur statusi i personave paraplegjik dhe tetraplegjik të ndarë në vite në periudhën 2019-2023. Sipas të dhënave të ofruara rezultoi se arsyeja kryesore e ndryshimit të numrit të personave që kanë statusin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik është për shkak të vdekjes.
11. Lidhur me të dhënat e ofruara nga MFPT, me 2 nëntor 2023, Zyra e Avokatit të Popullit ka zhvilluar një takim me Drejtorin e Departamentit të Pensioneve në MFPT dhe bashkëpunëtorët e tij për të biseduar lidhur me çështjen në fjalë, me ç'rast nga MFPT u kërkuan informata më të detajuara lidhur me numrin aktual të personave që kanë statusin e personit paraplegjik dhe tetraplegjik.
12. Me 3 nëntor 2023, Avokati i Popullit ka pranuar nga MFPT të dhëna të detajuara lidhur me çështjet e ngritura gjatë takimit të datës 2 nëntor 2023 të paraqitura në mënyrë tabelare si më poshtë:


**RAPORTI I NUMRIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK NË TRI VITET E FUNDIT  
SI DHE RITJIA APO TRENDI I exponential 2952 mujor**

Muaji	Numri	Viti	Shuma
01	3123	2020	981,070.00
02	3122	2020	974,125.00
03	3110	2020	964,650.00
04	3103	2020	962,445.00
05	3086	2020	960,600.00
06	3071	2020	985,350.00
07	2899	2020	928,725.00
08	2938	2020	947,925.00
09	2891	2020	923,025.00
10	2839	2020	913,050.00
11	2833	2020	937,744.00
12	2797	2020	906,495.00
01	2749	2021	894,450.00
02	2712	2021	893,865.00
03	2697	2021	896,755.00
04	2675	2021	900,305.00
05	2632	2021	871,950.00
06	2602	2021	866,860.00
07	2689	2021	972,695.00
08	2680	2021	901,755.00
09	2693	2021	909,570.00
10	2695	2021	909,820.00
11	2686	2021	1,156,125.00
12	2662	2021	887,970.00

Muaji	Numri	Viti	Shuma
01	2685	2022	895,175.00
02	2697	2022	906,725.00
03	2741	2022	922,325.00
04	2743	2022	1,178,645.00
05	2277	2022	716,725.00
06	2646	2022	1,019,842.00
07	2543	2022	851,775.00
08	2497	2022	852,575.00
09	2537	2022	942,025.00
10	2575	2022	1,172,100.00
11	2516	2022	839,800.00
12	2542	2022	897,197.00
01	2470	2023	805,475.00
02	2562	2023	969,832.00
03	2693	2023	1,032,508.00
04	2767	2023	942,300.00
05	2647	2023	850,726.00
06	2655	2023	920,336.00
07	2737	2023	1,016,772.00
08	2900	2023	1,055,679.00
09	2846	2023	881,100.00



**NUMRI-VITET DHE TRENDI EXPONENTIAL**



Përgjigje nga MFPT-ja ( Raporti në formë tabelare)

13. Sa i përket shkaqeve të ankesave të parashtruara nga personat paraplegjik dhe tetraplegjik, për vitet 2019-2022, në Komisionin e Ankesave në nivel të ministrisë, dhe sa prej tyre janë të bazuara, të pabazuara apo të hedhura poshtë dhe cilat janë pretendimet kryesore të ankesave të paraqitura, MFPT ka sqaruar se ankesat kryesisht paraqiten nga personat që janë klasifikuar si përfitues i grupit të dytë apo personat të cilët janë orientuar për aplikim në skemën e pensioneve për personat me aftësi të kufizuar si dhe ka paraqitur të dhënat në mënyrë tabelare.

#### IV. SFONDI LIGJOR

14. Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe tetraplegjik, përkatësisht neni 3, par 1, përcakton shprehjet e përdorura në këtë ligj:

*1.1. Paraplegjikët – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme.*

*1.2. Tetraplegjikët – ose (kuadriplegjikët) – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme.*

15. Qëllimi i Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik është që të rregullohet statusi dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme të cilët marrin kompensim mujor.

16. Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, neni 17 [Komisioni Vlerësues], përcakton si në vijim:

*1. Përfituesit e këtij ligji i nënshtrohen vlerësimit të Komisionit Vlerësues të MPMS në zyrat rajonale.*

*2. Komisioni Vlerësues lëshon vlerësim, duke përcaktuar personin si përfitues të këtij ligji si dhe grupimin dhe nevojat e tij sociale.*

*3. Komisioni shqyrton kërkesat e përfituesve të këtij ligji, për njohje të statusit dhe beneficioneve.*

*4. Përbërja dhe përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues caktohet nga Qeveria me akt nënligjor sipas propozimit të MSH-së dhe MPMS-së ndërsa një (1) anëtar caktohet nga shoqatat e licencuara që ofrojnë shërbime për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë në cilësinë e vëzhguesit.*

17. Rregullorja (QRK) Nr. 07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, neni 9 [Rivlerësimi] përcakton si në vijim:

*1. Në bazë të vlerësimit të Komisionit Vlerësues, përfituesit e grupit të parë me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve do t'i nënshtrohen rivlerësimit në çdo pesë vite, kurse për përfituesit e grupit të dytë që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve rivlerësimi konform Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.*

*2. Në rastet e caktuara, kur natyra e sëmundjes është në zhvillim të shpejtë me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve, përfituesi i grupit të dytë mund të aplikojë edhe para periudhës prej tri vitesh për procedurë të përshpejtuar në organet kompetente të MPMS-së.*

### III. ANALIZA LIGJORE DHE KONSTATIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

18. Ligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, trajton humbjen në formë të përhershme të mundësisë së zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve sipërme apo/dhe të poshtme. Pra në të dyja rastet bëhet fjalë për një gjendje të përhershme.

19. Ligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik në nenin 17 përcakton se përfituesit e këtij ligji i nënshtrohen vlerësimit të Komisionit Vlerësues, i cili shqyrton kërkesat e përfituesve të këtij ligji për njohje të statusit dhe beneficioneve,

ndërsa vet ligji nuk përcakton ri-vlerësim të statusit të personave paraplegjik dhe tetraplegjik. Po ashtu, neni 17, paragrafi 4 i ligjit përcakton se qeveria me akt nënligjor do të caktojë përbërjen dhe përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues.

20. Rregullorja (QRK) Nr. 07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, neni 9 i kësaj rregulloreje parasheh se: *“Në bazë të vlerësimit të Komisionit Vlerësues përfituesit e grupit të parë me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve do t’i nënshtrohen rivlerësimit në çdo pesë vite, kurse për përfituesit e grupit të dytë që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve rivlerësimi konform Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.*
21. Sipas dispozitave të paragrafit 1 të nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2017 personat paraplegjik dhe teraplegjik të grupit të parë obligohen që t’i nënshtrohen ri-vlerësimit çdo pesë vite, ndërsa për përfituesit e grupit të dytë në këtë nen nuk përcaktohet ndonjë afat por thuhet se rivlerësimi bëhet konform Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, ligj ky i cili nuk përcakton grupe të përfituesve dhe as rivlerësim të statusit. Rrjedhimisht kjo dispozitë nuk ka as mbështetje në ligj dhe po ashtu ka probleme të dukshme në formulim.
22. Avokati i Popullit, konstaton se Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik nuk përcakton rivlerësimin e statusit të personave paraplegjik dhe tetraplegjik në Kosovë dhe se rivlerësimi, grupet e përfituesve dhe afatet e rivlerësimit janë përcaktuar me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.
23. Avokati i Popullit vëren se Rregullorja (QRK) Nr. 07/2017, përkatësisht neni 9 i saj, jo vetëm se nuk ka mbështetje në ligj por përmban edhe cilësime kontradiktore sikur me ligjin ashtu edhe me vet përmbajtjen e saj. Neni 5, paragrafin 1, nënparagrafin 3 dhe nënparagrafin 4, me të cilat përcaktohen grupi i parë dhe grupi i dytë i personave paraplegjik dhe tetraplegjik, është si në vijim:
  - 1.3. *Përfituesit e grupit të parë janë persona me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve;*
  - 1.4. *Përfituesit e grupit të dytë janë persona që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve;*
24. Përderisa përcaktimi i grupit të parë definohet në mënyrë të qartë, ekzistojnë paqartësi në definimin e grupit të dytë ngase dispozitat e nën-paragrafit 1.4 fiasin për pasoja që nuk janë të përhershme ndërsa ligji dhe vet rregullorja trajtojnë humbjen e ndjeshmërisë në formë të përhershme. Kjo mbase mund të paraqesë çështje që kërkon ekspertizë mjekësore, megjithatë formulimi si i tillë lenë hapësirë për interpretime të pasakta ligjore.

25. Në anën tjetër, nëse krahasojmë nenin 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i Rregullores që përcakton grupin e parë të personave paraplegjik dhe tetraplegjik me nenin 9, paragrafi 1 i Rregullores që përcakton rivlerësimin çdo pesë vite të këtyre personave vërehet qartazi se mungon logjika e të pasurit nevojë për një rivlerësim të personave që janë përcaktuar në grupin e parë.
26. Për më tepër, Avokati i Popullit vlerëson se rivlerësimi i personave paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë përbën shkelje të të drejtave, si në vijim:

### *Dinjteti i Njeriut*

27. Dinjtetit e personave paraplegjik dhe tetraplegjik në rend të parë cenohet për shkak të vështirësive praktike që ata i kanë për tu paraqitur para Komisionit Vlerësues, aq më parë që Rregullorja nuk ka paraparë shprehimisht obligimin që Komisioni Vlerësues të mund t'i vizitojë këta persona në vendbanimet e tyre. Avokati i Popullit në shumë prej raporteve të tij ka gjetur se qasshmëria në hapësirat dhe objektet publike për personat me aftësi të kufizuar në përgjithësi është jashtëzakonisht e vështirë, ndërsa për personat paraplegjik dhe tetraplegjikë situata është akoma më e rëndë, e që mungesa e qasjes paraqet shkelje në vete. Barrën kryesore për sjelljen e personave paraplegjik dhe tetraplegjik e bartin anëtarët e familjes të cilët obligohen të gjejnë mënyra për t'i sjellë këta persona para komisionit, në mënyrë që Komisioni të ri-vlerësojë shkallën e aftësisë së kufizuar. Avokati i Popullit konsideron se lëshimet e mundshme të Komisionit Vlerësues me rastin e vlerësimit fillestar nuk guxojnë të shkojnë në dëm të dinjtetit të personave paraplegjik dhe tetraplegjik.
28. Sa i përket dinjtetit të njeriut nuk ekziston ndonjë përkufizim, madje edhe vet Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka një zbrazëti sa i përket përfshirjes së këtij koncepti në brendinë e saj. Megjithatë, kjo zbrazëti plotësohet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila dinjtetin e njeriut e trajton në 2122 vendimet e saj. Dinjteti është një nga konceptet më të përfolura në diskutimet akademike për të drejtat e njeriut. Pavarësisht nga kjo, dinjteti është ndoshta edhe një nga idetë më të studiuara dhe më të teorizuara për shkak të rëndësisë së tij supozuese si një bazë e mbrojtjes së të drejtave. Duke filluar me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut në periudhën e hershme të pasluftës, referenca për dinjtetin mund të gjenden në preambulat dhe dispozitat thelbësore të shumicës dërrmuese të traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Përgjatë gjysmës së dytë të shekullit të 20-të, kjo praktikë hartuese u vendos edhe për konventat rajonale të të drejtave të njeriut dhe kushtetutat kombëtare. Konceptimi i dinjtetit që supozohet se mbështet këto tekste është ai i dinjtetit njerëzor – si vlerë e qenësishme dhe për rrjedhojë e barabartë për të gjithë individët që e zotërojnë dinjtetin thjesht për shkak të qenësisë njerëzore dhe që u jep të drejtën e respektit dhe mbrojtjes nga ana shtetit.<sup>1</sup>
29. Po ashtu, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dinjtetit të njeriut i referohet nëntë herë duke përfshirë këtu edhe dispozitat që përcaktojnë qëllimin e Konventës në nenin 1 të saj:

*“Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë, mbrojë dhe të sigurohet që të gjithë personat me*

---

<sup>1</sup> iCourts Working Paper Series, no. 287, 2022 Language and Persuasion: Human Dignity at the European Court of Human Rights Veronika Fikfak and Lora Izvorova Forthcoming in Human Rights Law Review 2022 iCourts – The Danish National Research Foundation’s Centre of Excellence for International Courts



*aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.”*

30. Përndryshe edhe vet Ligji nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, në nenin 5 të tij përcakton se: *“Përfituesit e këtij ligji kanë të drejtën e mbrojtjes së dinjitetit dhe për respekt ndaj integritetit të tyre fizik dhe mendor në bazë të barabartë me personat e tjerë.”*

### ***Pritjet Legjitime***

31. Avokati i Popullit dëshiron të vë në pah se kur bëhet fjalë për beneficionet e njohura me ligj të personave me aftësi të kufizuar, në këtë rast personave paraplegjik dhe tetraplegjik, duhet të merret parasysh fakti se përderisa ekzistonë shkalla e njohur e aftësisë së kufizuar, beneficionet dhe të drejtat e njohura nuk mund të kufizohen apo reduktohen as me ndryshimin e vetë ligjit. Lidhur me këtë Avokati i Popullit i referohet praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Béláné Nagy v. Hungary*, Aktgjykimi i datës 10 shkurt 2015.
32. Kërkuesses, në rastin *Béláné Nagy v. Hungary*, iu dha një pensioni aftësisë së kufizuar, i cili u tërhoq në vitin 2010 pasi shkalla e saj e aftësisë së kufizuar u rivlerësua në një nivel më të ulët duke përdorur një metodologji të ndryshme. Ajo iu nënshtrua ekzaminimeve të mëtejshme në vitet në vijim dhe përfundimisht u vlerësua në nivelin kualifikues. Megjithatë, legjislacioni i ri i cili hyri në fuqi në 2012 prezantoi kritere shtesë të përshtatshmërisë në lidhje me kohëzgjatjen e mbulimit të sigurimeve shoqërore, kërkuësja nuk i plotësonte këto kritere. Si pasojë, edhe pse shkalla e saj e aftësisë së kufizuar do t'i kishte dhënë asaj të drejtën për një kompensim për aftësinë e kufizuar sipas sistemit të ri, aplikimet e saj u refuzuan. Pra, pensioni/ndihma për aftësinë e kufizuar ishte një e drejtë e pamohueshme për një përfitim të mirëqenies, e njohur sipas ligjit të brendshëm. Në këtë drejtim, ekzistenca e pritshmërisë legjitime të vazhdueshme dhe të njohur të kërkuesses për të marrë kujdesin për aftësinë e kufizuar u demonstrua nga fakti se ajo iu nënshtrua rishikimeve periodike të shkallës së saj të paaftësisë. Sa i përket çështjes nëse pritshmëria legjitime për të marrë kujdesin e aftësisë së kufizuar kërkon të drejtën për të mos ndryshuar kriteret e përshtatshmërisë, GjEDNj vuri në dukje se udhëzimet etike të përcaktuara në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë nuk duhet të përdoren për të mohuar të drejtat e vendosura ose për të kufizuar të drejtat legjitime për përfitime për individët.
33. Rivlerësimi i personave paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë, sipas ligjit dhe rregullores, nuk mund të sjellë përkrahje dhe beneficione shtesë sepse aktualisht këta persona janë përfitues të të gjitha përfitimeve dhe përkrahjes që ofron ligji. Së këndejmi, qëllimi i rivlerësimit e duke marrë parasysh që bëhet fjalë për një gjendje të përhershme e cila nuk mund të ndryshojë, zvogëlimi apo humbja e beneficioneve nuk duhet të vihen në diskutim.
34. Avokati i Popullit, në bazë të të dhënave të pranuar nga MFPT vlerëson se nuk ka pasur zvogëlim të numrit të përfituesve në përgjithësi dhe se arsyeja kryesore e zvogëlimit të numrit është vdekja. Përndryshe vërehet se ka pasur rritje të numrit të përfituesve, nëse si shembull marrim vitin 2022 dhe 2023. Sipas MFPT numri i përfituesve në vitin 2022 ka qene 2542 dhe se 317 nga ta kanë ndërruar jetë, ndërsa në vitin 2023 numri i përfituesve është 2737, që i bie se ky numër është rritur për 512 persona për dallim nga viti paraprak.

35. Sa i përket rivlerësimit të personave paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të dytë, Avokati i Popullit vlerëson se ri-vlerësimi duhet të bëhet vetëm në rast kur ka përkeqësim të gjendjes dhe kur qëllimi i ri-vlerësimit është ngritja e beneficioneve dhe përkrahjes ndaj këtyre personave dhe që një dispozitë e tillë të përfshihet në ligj.

### *Parimet e Sundimit të Ligjit*

36. Rregullorja (QRK) Nr. 07/2017 për Përbërjen, Funksionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik nuk është në pajtim me Ligjin nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik ngase ka përcaktuar kufizime të të drejtave të cilat garantohen me ligj.
37. Kufizim i të drejtave të njeriut të përcaktuara me aktet ligjore të miratuara nga Kuvendi (Kushtetuta dhe ligjet) nëpërmes akteve nën-ligjore të miratuara nga Qeveria është në kundërshtim me nenin 55, paragrafi 1, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.”*
38. GJEDNJ sikur edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës<sup>2</sup> duke u bazuar në praktiken e GJEDNJ ka trajtuar çështjen e kufizimit të “përcaktuar me ligj” dhe mënyrën se si GJEDNJ e analizon se a është një kufizim ose ndërhyrje e ndërmarrë e përcaktuar me dhe në ligj apo jo.
39. Në rastin *Tommaso kundër Italisë*, GJEDNJ, në mes tjerash, kishte theksuar se: “shprehja “në pajtim me ligjin” jo vetëm që kërkon që masa e kontestuar duhet të ketë një bazë në të drejtën e brendshme, por gjithashtu i referohet cilësisë së ligjit në fjalë, duke kërkuar që ai duhet të jetë i arritshëm për të personat në fjalë dhe i parashikueshëm sa i përket efekteve të tij. Më tutje, GJEDNJ, kishte theksuar se: *“një rregull është “i parashikueshëm” kur siguron një masë të mbrojtjes kundër ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike”* dhe se një ligj *“i cili jep një diskrecion duhet të tregojë fushën e këtij diskrecioni, megjithëse procedurat dhe kushtet e hollësishme që duhen respektuar jo domosdoshmërisht duhet të përfshihen në rregullat e së drejtës materiale.”* (Shih, *Tommaso kundër Italisë*, kërkesa nr. 43395/09, Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafët 106-109 dhe referencat e cituara aty.)
40. Në rastin *Dubrovina dhe të tjerët kundër Rusisë*, GJEDNJ kishte ritheksuar se: “shprehja “e përcaktuar me ligj” jo vetëm që kërkon që masa e kontestuar të ketë një bazë ligjore në të drejtën e brendshme, por gjithashtu i referohet cilësisë së ligjit në fjalë, i cili duhet të jetë i arritshëm për personin në fjalë dhe i parashikueshëm sa i përket efekteve të tij. [...]. Në çështjet që prekin të drejtat themelore do të ishte në kundërshtim me sundimin e ligjit, një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike të parashikuar në Konventë, që diskrecioni ligjor i dhënë ekzekutivit të shprehet në termat e një pushteti të papenguar. Si pasojë, ligji duhet të tregojë me qartësi të mjaftueshme fushën e çdo diskrecioni të tillë dhe mënyrën e ushtrimit të tij.

<sup>2</sup> Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 23 marsit 2020 Nr. të lëndës KO 54/20

41. Avokati i Popullit, duke u bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.*” Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: “*(...) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (...).*”; si dhe: “*Të rekomandojë [...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.*” (Neni 18, paragrafi 1.7).

## REKOMANDON

### Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve:

1. Që të plotësojë dhe të ndryshojë Rregulloren (QRK) Nr. 07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, si në vijim:
  - a. Të ndryshojë Nenin 5, paragrafin 1, nën-paragrafin 1.4 në atë mënyrë që grupi i dytë i personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë të definohet në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik duke vënë në pah faktin se gjendja e personave të grupit të dytë është gjendje e përhershme por në shkallë më të ulët krahasuar me personat e grupit të parë.
  - b. Të fshijë komplet paragrafin 1 të nenit 9 që përcakton rivlerësimin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë në çdo pesë vite, dhe që përcakton se për përfituesit e grupit të dytë që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve rivlerësimi konform Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.
2. Të iniciojë procedurat për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik në atë mënyrë që:
  - a. Ligji të përcaktojë grupimin e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe të definojë grupet e përfituesve nga ky ligj;
  - b. Të përcaktojë se Komisioni Vlerësues nuk mund të rivlerësojë personat paraplegjik dhe tetraplegjik të cilëve u është njohur statusi i personave të grupit të parë;
  - c. Rivlerësimi i personave paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të dytë të bëhet vetëm në rastet e caktuara, kur natyra e sëmundjes është në zhvillim të shpejtë dhe për pasojë ka përkeqësimin e gjendjes shëndetësore.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar*

rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit

